




Primitur / Dorezuar Punigjenos/Prudato Received/Delivered	04.02.2021	viti god year	
Organ / Njësia Organ / Jedinstvo Org / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtesa Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKIMBICK	467/2021		1/3



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.27/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari- kryetare, Jeton Koca dhe Eshref Shabani - anëtar, si dhe Hysni Mustafa- Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit për shqyrtimin e ankesës me numër A.nr.27/2021 të datës 26.01.2021, të parashtruar nga ankuesja _____ të cilën me autorizim e përfaqëson Avokat _____ rruga “Afrim Zhitia” pa numër në Mitrovicë, kundër organit të punësimit/Spitali i Përgjithshëm në Mitrovicë “Dr. Sami Haxhibeqiri”, në çështjen juridike “shkelje e të drejtës në pagë” duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës , në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 02.02.2021, mori këtë:

V E N D I M

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, shpallet jo kompetent për të vendosur për ankesën me numër A.nr.27/2021 e datës 26.01.2021 e parashtruar nga ankuesja _____

A r s y e t i m

Ankuesja _____ përmes përfaqësuesit të saj Avokat _____ më datë 24.01.2021 nëpërmjet Postës së Kosovës ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës e cila është pranuar më datë 26.01.2021 dhe është protokolluar më numër Nr. Port: 297/2021, me pretendimet ankimore për harmonizim të koeficientit.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokollit 297/2021 e datës 26.01.2021 e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Njoftim i datës 22.12.2020 nga Kryesuesi i Komisionit të Ankesave në Spitalin e Përgjithshëm të Mitrovicës; Vendimin e datës 02.11.2020

nga Këshilli Drejtues i Spitalit të Mitrovicës; Ankesë e datës 12.11.2020 e parashtruar në Komisionin e Ankesave; Akt emërimi i ankueses i datës 12.02.2013; Certifikata Ref.nr.392/0720 e datës 10.07.2020; Autorizimin e datës 22.01.2021; Kërkesën për ngritje të koeficientit e datës 17.09.2020.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, duke shqyrtuar të gjitha provat e lëndës, konstaton se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil i Kosovës, nuk është kompetent për vendosur për ankesën e parashtruar nga ankuesja *sepse:*

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, duke i'u referuar provave të lëndës, konstaton se ankuesja është në marrëdhënie punë në Shërbimin Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës respektivisht në Spitalin e Përgjithshëm "Dr. Sami Haxhibeqiri" në Mitrovicë në pozitën „Zyrtar i Shkrimores dhe Arkivës“.

Duke ju referuar Ligjit Nr. 04/L-125 për Shëndetësi, respektivisht nenit 62 paragrafit 6, përcaktohet që : *“Të punësuarit në SHSKUK nuk i takojnë shërbimit civil të Kosovës”,* rrjedhimisht të punësuarit në fushën e shëndetësisë në bazë të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë janë kategorizuar si nëpunës të shërbimit publik siç përcaktohet me nenin 2 paragrafin 2 nën paragrafin 2.2, ndërsa lidhur me këtë paragrafi 4 i nenit 2 të këtij ligji, përcakton që: *“Nëpunësi i Shërbimit Publik - është personeli i nivelit të lartë drejtues, drejtues, profesional dhe i shërbimeve të brendshme në administratën e shërbimeve publike, pjesë e administratës shtetërore apo në administratën e shërbimeve publike, pjesë e një komune të cilët ofrojnë shërbime publike të drejtpërdrejta për qytetarët në fushën e arsimit, shëndetësisë, kulturës, artit si dhe shërbime tjera të ngjashme publike”.*

Ndërlidhur me këtë pjesa V e Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, ka trajtuar në mënyrë të detajuar marrëdhënien e punës së nëpunësve të shërbimit publik, mbi këtë bazë dhe duke ju referuar dispozitave të nenit 6 paragrafit 1 nën paragrafit 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil i Kosovës, nuk është kompetent për vendosur për ankesën e parashtruar nga ankuesja, sepse Këshilli shqyrton dhe merr vendime për ankesat e nëpunësve civil dhe kandidatëve për pranim në shërbimin civil.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, meqenëse ka konstatuar se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nuk është kompetent për vendosur për ankesën e parashtruar nga ankuesja, atëherë udhëzon palën për ushtrimin e mjeteve juridike sipas nenit 24 paragrafit 4 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, i cili përcakton se: *“Nëpunësi i Shërbimit Publik dhe nëpunësi administrativ dhe mbështetës kanë të drejtë të ankohen sipas këtij ligji të punëdhënësi dhe më pas mund të fillojë kontest administrativ në gjykatën kompetente”.*


Duke marr parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe provat e bashkëngjitura në lëndë, Kolegji për shqyrtimin e ankesave, bazuar në nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.



Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.27/2021

Hysni Mustafa


Procesmbajtës

Malsore GASHI BAJRAKTARI


Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dorëzohet:

- Përfaqësuesit të ankueses, Avokat
- Drejtorit të Përgjithshëm të Spitalit të Mitrovicës;
- Udhëheqësit të Personelit në Spitalin e Përgjithshëm të Mitrovicës dhe
- Arkivit të KPMSHCK- së;

